KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat Afatshkurtra të Industrisë, Dhjetor 2023

8.03.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat Afatshkurtra të Industrisë për muajin dhjetor 2023.

Indeksi i vëllimit të prodhimit në Industri dhe numrit të të punësuarve dhjetor 2023, krahasuar me dhjetor 2022

Në muajin dhjetor të vitit 2023, indeksi i vëllimit të prodhimit në sektorët e industrisë kishte rritje në sektorin e industrisë përpunuese 2%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Dhjetor 2022).

Ndërsa, rënie kishte te: furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (-11%); industria nxjerrëse (minierat dhe guroret) (-8.2%); furnizimi me rrymë,avull dhe ajër të kondicionuar (-9%).

Aktivitetet ekonomike sipas NACE Rev-2



Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial ndryshimi për muajt Dhjetor (2023) –Dhjetor (2022) në përqindje % (2020=100)

Sektorët	Indeksi 2020=100		
	12-2022	12-2023	12-2022 / 12-2023
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	155.3	142.5	-8.2%
Industria përpunuese	168.0	171.3	2%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	213.1	194.3	-9%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	273.1	242.4	-11%

Indeksi i numrit të të punësuarve

Në muajin dhjetor 2023, indeksi i numrit të të punësuarve ishte në sektorin e industrisë përpunuese ishte 0,0%; Minierat dhe guroret (-11,1%); Furnizimit me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (-2%); sektori i furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (-8,%); krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (dhjetor 2022).

Indeksi i nurit të të punësuarve nga aktiviteti industrial për muajt Dhjetor (2023)–Dhjetor (2022) në perqindje% (2020=100)

Sektorët	Indeksi 2020=100		
	12-2022	12-2023	12-2022 / 12-2023
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	96.0	85.3	-11.1%
Industria përpunuese	107.3	106.9	0%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	91.4	90.0	-2%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	105.0	96.9	-8%

Për më shumë informata lidhur me Statistikat Afatshkurtra të Industrisë për muajin shtator 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ShortStats